

Vendim nr. 191, datë 11.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahim, Anëtar

në datën 11.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (L) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **LORETA MOKINI, ZHIRAJR MOKINI**, përfaqësuar nga avokati Endi Sinemati, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 738, datë 17.04.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2400 akti, datë 07.06.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 264, datë 24.03.2022 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2025-1111, datë 03.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 18, 31, 33, 35, 36, 37, 41, 42, 43, 71, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141, pika 1, 142, 145 dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit (nënë e bir) janë trashëgimtarët ligjorë të një shtetasi (respektivisht bashkëshorti i kërkueses dhe babai i kërkuesit), i cili ishte bashkëpronar i një pasurie të paluajtshme (shtëpi) në plazhin e Durrësit. Trashëgimlënësi kishte marrë dijeni se dy motrat e tij ia kishin dhuruar pjesën e tyre në bashkëpronësi fqinjit të tyre, nëpërmjet një kontrate dhurimi të hartuar nga një noter publik dhe të regjistruar më pas në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Më 21.12.2018 ai ka paraqitur kallëzim penal ndaj dy motrave, noterit publik që kishte përpiluar kontratën e dhurimit dhe regjistruesit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës (*ZVRPP, Durrës*), për veprat penale të kanosjes, të falsifikimit të dokumenteve dhe të shpërdorimit të detyrës, të parashikuara nga nenet 84, 186 dhe 248 të Kodit Penal (*KP*). Sipas kallëzimit, kontrata e dhurimit ishte fiktive, pasi në të vërtetë përfaqësonte një kontratë shitjeje, ndërsa noteri kishte detyrimin ta vinte atë paraprakisht në dijeni për kryerjen e këtij veprimi juridik.

2. Kallëzimi është regjistruar me nr. 738 të vitit 2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila, në vijim, ia ka dërguar aktet për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, në datën 27.02.2019, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi kallëzuesi ka paraqitur ankim në gjykatë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2400 akti, datë 07.06.2019, ka vendosur rrëzimin e ankimit, duke arsyetuar se vendimi i prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal ishte i drejtë. Gjykata ka vënë në dukje se kërkuesja Loreta Mokini ka paraqitur më parë kallëzim për të njëjtat fakte penale, për të cilin prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. 1274/2019. Ajo ka vlerësuar se mosmarrëveshja ndërmjet palëve kishte natyrë civile dhe se sipas Kodit Civil mosrespektimi i dispozitave që rregullojnë lidhjen e kontratës sjell si pasojë pavlefshmërinë e saj, pa krijuar përgjegjësi penale. Gjykata ka evidentuar gjithashtu se prokuroria kishte kryer verifikimet e nevojshme për të gjitha pretendimet e kallëzuesit, duke marrë në pyetje personat përkatës dhe duke administruar dokumentacionin përkatës nga ZVRPP-ja, Durrës.

4. Kallëzuesi ka paraqitur apel kundër këtij vendimi, por ai është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 264, datë 24.03.2022, e cila ka arsyetuar se fakti penal nuk ekzistonte. Sipas asaj gjykate, kontrata e dhurimit përfaqëson shprehjen e vullnetit të ligjshëm të palëve, të cilin noteri publik vetëm e vërteton, pa e formuar vetë, ndaj nuk mund të bëhet fjalë për falsifikim të vullnetit të tyre. Gjykata e apelit ka vlerësuar gjithashtu se nuk përmbusheshin elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, për sa kohë regjistruesi kishte vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbi bazën e vullnetit të shprehur nga palët. Sipas saj, çdo ves i mundshëm i vullnetit duhet të zgjidhet në rrugë civile, përmes konstatimit ose shpalljes së pavlefshmërisë së veprimit juridik, ndërsa nuk përbën kundërligjshmëri ose rrezikshmëri në kuptimin penal, për shkak të mungesës së objektit të veprës penale. Në këtë kuptim, gjykata ka theksuar se kallëzuesi mund të kundërshtojë kontratën e dhurimit në një proces civil, duke pretenduar të drejtën e parablerjes, por kjo mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhet në kuadër të procesit penal. Po kështu, ajo ka vlerësuar se nuk ishin të pranishme as elementet e veprës penale të kanosjes, pasi veprimet e të kallëzuarve nuk ishin të një natyre serioze dhe, për rrjedhojë, nuk përmbushej ana objektive e kësaj vepre penale. Në përfundim, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se ankimi nuk përmbante shkaqe që të çonin në ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

5. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1111, datë 03.07.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kallëzuesit, me arsyetimin se shkaqet e ngritura ishin të pabazuara.

6. Në datën 03.04.2026, kërkuesit, në cilësinë e trashëgimtarëve të kallëzuesit, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesve

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmblodhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1.1. *E drejta për hetim efektiv*, pasi vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është në kundërshtim me ligjin. Vendimi është marrë pas 44

ditëve, në shkelje të afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Prokurori ishte i detyruar të regjistronte procedimin penal dhe të verifikonte rrethanat e nenit 290 të KPP-së, duke kryer hetime të plota sipas neneve 250-252 të këtij kodi. Gjykata e Lartë, në përputhje me vendimmarrje të tjera të saj, duhet të kishte kontrolluar ligjshmërinë substanciale dhe jo vetëm atë formale të vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal.

7.1.2. *Parimi i barazisë së armëve*, pasi gjykatat nuk kanë shqyrtuar provat e dorëzuara nga kallëzuesi si CD-në me pohimet e të kallëzuarve, shkresat e ZVRPP-së në të cilat pranohej kundërligjshmëria e veprimeve të noterit dhe regjistruarit, kryeregjistruarit dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Gjykata e apelit ka kthyer pa veprime disa dokumente dhe akte të dërguara me shtesën e apelit. Çështja në gjykatën e apelit është shqyrtuar brenda së njëjtës ditë me 14 çështje të tjera. Mospranimi i provave nga prokuroria dhe gjykatat nuk u arsyetua në vendime, por ato u mjaftuan me një interpretim formal. Gjatë hetimit prokuroria vetëm ka pyetur të kallëzuarit, duke mos bërë asnjë ballafaqim mes tyre, dhe nuk i ka thirrur kërkuesit për t'i vënë në dijeni për veprimet e kryera.

7.1.3. *E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*, pasi vendimit të prokurorit dhe vendimeve gjyqësore, në shkelje të nenit 152 të KPP-së, u mungon analiza e thelluar për provat. Gjykatat e kanë krijuar bindjen e tyre bazuar mbi një vlerësim të pjesshëm të provave. Ato kanë kontrolluar formalisht veprimtarinë e prokurorisë, e cila nuk kishte kryer hetime të plota. Gjykatat nuk kanë përmendur shkresën e ZQRPP-së, që dokumenton shkeljet e ligjit dhe nuk kanë analizuar përgjegjësinë e regjistruarit. Gjykata e apelit nuk ka trajtuar veprën penale të falsifikimit ideologjik të parashikuar nga neni 186, paragrafi i tretë, i KP-së, por ka bërë trajtimin teorik të falsifikimit dhe përdorimit të akteve e dokumenteve në përgjithësi, të parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni, si dhe nuk ka evidentuar parregullsitë që vijnë nga ligji për noterinë dhe ai për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. I njëjti arsyetim është përdorur edhe për veprën

penale të kanosjes. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të paraqitura në rekurs dhe nuk ka kontrolluar mënyrën e arsyetimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta. Vendimet gjyqësore e kanë trajtuar çështjen në mënyrë të gabuar si një konflikt të thjeshtë administrativ ose civil, duke anashkaluar përgjegjësinë penale të personave të kallëzuar. Arsyetimi jo i plotë i gjykatave sjell që vendimet e tyre të jenë joproporcionale me interesin publik, pasi kanë bërë një interpretim të ngushtë, duke përjashtuar përgjegjësinë penale të personave të kallëzuar.

- 7.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi pranuesi i dhurimit ka ushtruar në mënyrë abuzive kërkesëpadinë për pjesëtimin e sendit të paluajjtshëm në pjesën 3/18 e saj. Këto veprime janë mbështetur më tej edhe nga kryeregjistruesi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Kërkuesit ndonëse janë pronarë të ligjshëm janë të pambrojtur nga ndërhyrjet e paligjshme dhe nga shkeljet e individëve të tjerë, ose autoritetet publike. Vendimi i prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal ka favorizuar përfituesin e pronës duke cenuar të drejtën e gëzimit të qetë të pronës. Procesi penal i nisur nga kallëzuesi kishte mundësi të zgjidhte mosmarrëveshjen në mënyrë të shpejtë, në ndryshim nga procesi civil i cili është në pritje prej 9 vjetësh në fazën e parë.
- 7.3. *E drejta për jetë private*, pasi procesi gjyqësor ka ndikuar negativisht në jetën familjare të kërkuesve, veçanërisht duke mbajtur parasysh faktin se kallëzuesi ka qenë person me aftësi të kufizuara.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesve

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor ose akti publik që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik

të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, individit duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuessit kanë kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur mosfillimin e procedimit penal të regjistruar mbi kallëzimin penal të paraqitur nga trashëgimlënësi i tyre. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuessit e justifikojnë interesin e tyre në çështjen e parashtruar, pasi trashëgimlënësi, në cilësinë e kallëzuesit, ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

10. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Kolegji evidenton se kërkuessit duhet të justifikojnë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

11. Në rastin konkret, kërkuessit kanë kundërshtuar vendimin e prokurorit për mosndjekjen penale të personave të kallëzuar për veprat penale të kanosjes, të shpërdorimit të detyrës dhe të falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara nga nenet 84, 186 dhe 248 të KP-së. Lidhur me ankimin e kallëzuesit ndaj këtij vendimi, gjykatat kanë arritur në përfundimin se me të drejtë prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi faktet e kallëzuara, në ngarkim të të kallëzuarve, përbëjnë mosmarrëveshje civile, pra nuk përmbajnë elemente të veprave penale.

12. Për sa më lart, Kolegji evidenton se ndonëse pretendimet e kërkuessve kanë të bëjnë me paligjshmërinë e veprimeve të të kallëzuarve (motrave të kallëzuesit në cilësinë e dhurueseve të pasurisë së përbashkët, përfituesit të kësaj pasurie, noterit, i cili ka përpiluar kontratën e dhurimit dhe regjistruessit të pasurisë), në thelb ato lidhen me të drejtën e pronës dhe me të drejtën e

parablerjes. Ndonëse ata kanë pretenduar se padia civile dhe padia penale mund të gjykohen së bashku ose të ndara, kjo nuk i kushtëzon ata në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale që kërkuesit pretendojnë se u janë shkelur. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se kërkuesit nuk kanë arritur të argumentojnë se në çfarë mënyre vendimet gjyqësore të kundërshtuara në ankimin kushtetues individual kanë cenuar të drejtën e pronës private të mbrojtur nga neni 41 i Kushtetutës. Po kështu, Kolegji evidenton se rivendosja e së drejtës së pronës private që pretendohet se është cenuar, në rastin konkret, nuk varet nga mënyra e përfundimit të proceseve penale të kundërshtuara. Kjo do të thotë se edhe në rastin e një vendimi penal në favor të kërkuesve, mjeti i përdorur prej tyre nuk provohet se do të ofronte një perspektivë suksesi në drejtim të mbrojtjes të së drejtës substanciale.

13. Nga ana tjetër, Kushtetuta nuk garanton të drejtën për të filluar ndjekjen penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre, në të njëjtën mënyrë sikundër është shprehur edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me mbrojtjen e të drejtave konventore në këtë drejtim (shih *Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë*, datë 19.09.2006).

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuesve në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tyre. Për rrjedhojë, kërkuesit nuk legjitimohen *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.